



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Nr. 72 Prot.

Gjirokastër, më 16.01.2025

MIRATOI
REKTOR
Prof. Dr. Jaho ~~CANA~~



Lënda: Hapet turrja për pjesëmarrje në aktivitetet e organizuara nga Universiteti Aristotle i Selanikut, Greqi.

1. Ekipi i Universiteti Aristotle të Selanikut, Greqi, pjesë e grupit të punës për zbatimin e projektit për mbështetjen e kërkuesve në rrezik "Inspireurope+", organizon një workshop për kontakt rajonal në 13 Mars 2025, në Selanik, Greqi.

Ky seminar synon të sjellë së bashku përfaqësues të nivelit të lartë të IAL-ve evropiane, akademike, personel të nivelit të lartë administrativ, përfaqësues kombëtarë, OJQ, partnerë projekti dhe studiues në rrezik për të promovuar vlerat thelbësore akademike (veçanërisht lirinë akademike, integritetin akademik dhe përgjegjësinë akademike) në perspektivën evropiane dhe globale, me fokus në Evropën Jugore dhe Juglindore.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet mund të jetë fizike ose online dhe është e hapur për të gjithë, pa limit. Të interesuarit mund të regjistrohen deri në datën 15 shkurt 2025 në linkun [here](#).

2. Seminari i mësipërm është pjesë edhe e javës së Trajnimit të Stafit të organizuar nga Departamenti i Programeve Arsimore Evropiane të Universitetit Aristotle të Selanikut, në emër të Task Forcës së Rrjetit të Utrecht për Ndërkombëtarizimin e Përgjegjshëm dhe Angazhimin Global (RIGE Task Force), mbi "Ndërkombëtarizimi i Përgjegjshëm dhe Mbështetja Institucionale për Aksesin e Dijetarëve në Rrezik në Arsimin e Lartë, Trajnimin dhe Punësimin".

Trajnimi i Stafit do të mbahet në periudhën 10-14 mars 2025 dhe do të fokusohet në një sërë temash rreth angazhimit global në arsimin e lartë, ndërkombëtarizimit të përgjegjshëm, mbështetjes së studiuesve në rrezik dhe promovimit të lirisë akademike.

Nëse jeni i përfshirë në këtë temë, mund të paraqisni aplikimin tuaj deri në 20 janar 2025. Për këtë aktivitet ka një numër të kufizuar pjesëmarrësish dhe aplikimet do të shqyrtohen në përputhje me rrethanat.

Shënim: Pjesëmarrja në seminar është e pavarur nga pjesëmarrja në Javën e Trajnimit të Stafit. Nuk ka tarifë për pjesëmarrjen në Javën e Trajnimit të Stafit, megjithatë, pjesëmarrësit janë përgjegjës për mbulimin e akomodimit të tyre.

Informacion: <https://eurep.auth.gr/en/staff/training/estw/utrecht-rige-2025>

Aplikim: <https://eurep.auth.gr/en/stafftraining/applicationform> (Për të hyrë në faqen e aplikacionit, së pari duhet të identifikoheni. Nëse nuk keni një llogari, mund të krijoni një të tillë në linkun: <https://eurep.auth.gr/en/user/register>)

Kontakt: estw@auth.gr

Përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor

Irma Gjolleshi

